



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-18222
Dt: 20.04.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve, me datë 20.04.2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Arben Bakalli, emërohet anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A.
2. Ky vendimi i dërgohet Kuvendit të Komunës për të emëruar edhe dy anëtarë të tjerë nga radhët e Kuvendit, siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i’u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
- Anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

